

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 435/2008
22 qershor 2009
Prishtinë

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës, në kolegjin e formuar në përputhje me nenin 26, paragrafin (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), dhe nenin 15.4 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (“Ligji mbi Kompetencat”);

Të përbërë nga Guy Van Craen, Gjyqtar i EULEX-it, në cilësinë e Kryetarit të kolegjit dhe të gjyqtarit raportues si dhe nga Gjyqtarët e Gjykatës Supreme, Miftar Jasiqi dhe Agim Krasniqi, si anëtarë të kolegjit;

Të ndihmuar nga Mircea Cristian Nicoara, zyrtar ligjor i EULEX-it, si procesmbajtës, Stephen Parkinson dhe Ann Elizabeth Bateman, si procesmbajtës gjyqësorë të EULEX-it, Arlinda Gjebrea, Arben Pallaska, Vegim Rugova dhe Naser Sylja, si përkthyes të EULEX-it;

Në prani të Theo Jacobs, Anette Milk, Prokurorë të EULEX-it, Zyhra Ademi, Prokurore Publike, Avokatit mbrojtës Tomë V. Gashi për Leme Xhemën; Musa Xh. Dragusha, Xhafer Maliqi dhe Shpresa Rama për Mustafa Nezirin;


Në seancat e mbajtura më 26 maj dhe 16 qershor 2009, pas këshillimit të kolegjit të kryer më 22 qershor 2009;

Në lëndën penale kundër:

Leme Xhemës: të lindur në Medvegje, më 24 mars 1958, nga i ati Ibrahim Xhema, e ëma Sofi me mbiemër të vajzërisë Bislimovic, me vendbanim në rrugën Mbreti Longordi në Prishtinë, shqiptare kosovare, ekonomiste, e martuar, nënë e tre fëmijëve, ka të kryer fakultetin e ekonomisë, me gjendje ekonomike mesatare;

Për veprat penale të **Shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit si bashkëkryerëse** me të dyshimtë të tjerë kundër të cilëve është paraqitur aktakuza e veçantë, në kundërshtim me nenin 25 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KP të RSFJ-së) dhe nenin 210, paragrafët (1) dhe (4) të Ligjit Penal të Kosovës (LPK), dhe të **Lidhjes së kontratës së dëmshme**, në kundërshtim me nenin 109, paragrafët (1) dhe (2) të LPK-së;

Aktgjykimi
Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 435/2008
Leme Xhema *et alia*



Dhe kundër:

Mustafa Nezirit: të lindur në Prishtinë, më 20 nëntor 1966, nga i ati Veli Neziri, e ëma Miradje me mbiemër të vajzërisë Greqevci, banues në rrugën Hamdi Gashi nr. 93, Velani, Prishtinë, shqiptar kosovar, afarist, me diplomë fakulteti, i martuar, baba i tre fëmijëve, me gjendje ekonomike mesatare;

Për veprën penale të **Fshehjes**, në kundërshtim me nenin 154, paragrafin (1) të LPK-së;

Duke vendosur rreth ankesës së Avokatit mbrojtës Tomë V. Gashi, të paraqitur në dobi të të pandehurës Leme Xhema, më 6 gusht 2008;

Si dhe rreth ankesës së përbashkët të avokatëve mbrojtës Musa Dragusha, Xhafer Maliqi dhe Shpresa Rama, të paraqitur në dobi të të pandehurit Mustafa Neziri, më 7 gusht 2008;

Të paraqitur kundër aktgjykimit P. Nr. 826/06 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, të datës 9 maj 2008;

Pas shqyrtimit të shënimeve të gjykatës, pas dëgjimit të argumenteve të avokatëve mbrojtës si dhe të Prokurorit Publik, dhe pas analizës së ligjeve përkatëse;

Në bazë të nenit 426, paragrafit (1) të KPPK-së, Gjykata Supreme e Kosovës, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, P. Nr. 826/06, i datës 9 maj 2008, **VËRTETOHET PJESËRISHT.**

Ankesa e avokatit mbrojtës Tomë Gashi, e paraqitur në dobi të të pandehurës Leme Xhema, më 6 gusht 2008 **PRANOHET PJESËRISHT;**

Ankesa e përbashkët e avokatëve mbrojtës Musa Dragusha, Xhafer Maliqi dhe Shpresa Rama, e paraqitur në dobi të të pandehurit Mustafa Neziri, më 7 gusht 2008, **PRANOHET**

Aktgjykimi P. Nr. 826/06 i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, i datës 9 maj 2008, **NDRYSHOHET.**

E pandehura Leme Xhema dënohet me **tre (3) vjet burgim;**

I pandehuri Mustafa Neziri lirohet nga të gjitha akuzat për shkak të kalimit të afatit të parashkrimit;

Aktgjykimi
Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 435/2008
Leme Xhema et alia



Leme Xhema obligohet që të paguajë shumën prej 300,000 (treqind mijë) eurosh për Palën e dëmtuar Ndërmarrjen e postës dhe telekomunikacionit në territorin e Kosovës, si pagesë të plotë për kërkesën e tyre pronësore juridike brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dorëzimi i këtij aktgjykimi;

Pala e Dëmtuar udhëzohet që mund të paraqesë padi pronësore përmes procedurës civile kundër Mustafa Nezirit, sipas nenit 112, paragrafit (3) të KPPK-së.

Leme Xhema do ta paguajë ndaras shumën e caktuar në paushallin e zakonshëm prej 200 (dyqind) eurosh në emër të shpenzimeve të procedurave penale;

Pjesa tjetër e aktgjykimit P. Nr. 826/06 të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, e datës 9 maj 2008, vërtetohet.

Arsyetimi

1. Procedura

- Aktakuza kundër të pandehurve Leme Xhema dhe Mustafa Neziri është paraqitur më 2 nëntor 2006, pastaj është ndryshuar më 6 nëntor 2006 dhe 4 qershor 2007, dhe në fund konfirmimi ka përfunduar më 14 qershor 2007. Shqyrtimi gjyqësor ka filluar më 14 prill 2008 dhe aktgjykimi i (shkallës së parë) është shpallur më 9 maj 2008. Prokurori Publik ka paraqitur mendimin e tij lidhur me ankesat e të pandehurve (6 dhe 7 gusht 2008) më 4 dhjetor 2008. Më 2 janar 2009 lënda është transferuar nga UNMIK-u te EULEX-i.

-Ankesat e paraqitura nga avokati mbrojtës Tomë Gashi në emër të Leme Xhemës dhe nga avokatët mbrojtës Musa Dragusha, Xhafer Maliqi dhe Shpresa Rama në emër të pandehurit Mustafa Nezirit, të paraqitura brenda afatit ligjor, janë të pranueshme.

- Pala e dëmtuar, ndërmarrja publike PTK (nenet 107 – 108 të KPPK-së) edhe pse e ftuar në mënyrë të rregullt, nuk është paraqitur në Gjykatën Supreme.

2. Parashkrimi lidhur me ndjekjen penale

- I pandehuri Mustafa Neziri akuzohet për veprën penale të fshehjes (neni 154 LPK-së) e cila është e dënueshme deri në tre vjet burgim. Asnjë ndjekje penale nuk mund të fillojë pas kalimit të periudhës 3 vjeçare (neni 90 (1) 4 të KPK-së) nga kryerja e kësaj vepre penale të fshehjes. *In casu*, kryerja e veprës ka ndodhur në mes të muajve shkurt dhe prill 2003, më shumë se gjashtë vite më parë, që do të thotë ka kaluar periudha e dyfishtë e parashkrimit (neni 91 (6) të KPK-së). Prandaj, të gjitha akuzat kundër Mustafa Nezirit janë refuzuar (neni 389 (4) i KPPK-së), dhe pala e dëmtuar PTK-ja është udhëzuar që të bëjë padi pronësore-juridike pranë gjykatës kompetente civile (neni 112 (3) të KPPK-së).

Aktgjykimi
Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 435/2008
Leme Xhema *et alia*



3. Faktet dhe akuzat lidhur me të pandehurën Leme Xhema:

- Gjykata Supreme ka përcaktuar që vendimi i ankimuar i shkallës së parë ka përshtetur dhe përcaktuar në mënyrë të duhur faktet materiale bazuar në dëshmitë e paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor.

- Në veçanti Gjykata, bazuar në analizat e dëshmitarëve, të dokumenteve të marra në mënyrë ligjore dhe duke marrë parasysh mjedisin e veçantë publik të punës, të rregulluar në mënyrë strikte, të të pandehurit me shkathtësi të larta konstaton që:

a. e pandehura Leme Xhema ka aranzhuar transferin e 300.000 Euro duke e ditur që;

- ajo nuk ka pasur autorizim për ta bërë apo nënshkruar këtë transfer. Nuk ka pasur aprovim eksplicit nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) dhe e pandehura asnjëherë nuk ka kërkuar aprovim formal, që nuk është veprimtari e rëndomtë afariste (jo tipike/ punë e përditshme e PTK-së për tu marrë me rrjetin-Tetra, duke pasur parasysh këtë shumë të të hollave dhe krijimin e kompanisë së përbashkët) do të ishte më së paku e nevojshme duke qenë Menaxher Gjeneral, specialist në ekonomi dhe afarizëm, e pandehura, ajo më shumë se çdokush tjetër, i di dhe duhet të dijë rregullat e aplikueshme lidhur me kontratat afariste dhe transfere të parave.

- pagesa e kësaj shume (enorme) të parave nga ndërmarrja publike të një kompanie private sapo të regjistruar nuk ka pasur arsyetim të vërtetë sepse kjo kompani ka ekzistuar vetëm disa muaj dhe nuk ka pasur/nuk ka mundur të ketë veprimtari siç është cekur në këtë faturë/dëftesë shumë të përgjithësuar që e mbulon periudhën prej 01.06.2002 – 10.03.2003. Kompania Kosovare Norway Invest është regjistruar më 10.12.2002, që është gjashtë muaj më vonë se “veprimtaria” e parë e faturuar.

- nuk ka pasur kontratë të para-krijuar nga e cila PTK-ja do të kishte obligim për ti paguar shpenzimet e ashtuquajtura në shumë prej 300.000 Euro. Kjo ngarkesë enorme financiare për PTK-në është dashur që së paku të ketë një kontratë të qartë me shkrim mirëpo *In casu* nuk ka qenë as çështje e Memorandumit të Mirëkuptimit (MM) i cili ka pas për qëllim krijimin e kësaj kompanie të përbashkët (ARTET) për ta planifikuar rrjetin-Tetra.

- kompania Kosovare Norway Invest R&O, Norway Invest Ndërkombëtar, Norway Invest Sh.p.k, Norway Invest AS, apo kompanitë e tjera të ndërlidhura, nuk ka pasur marrëdhënie ligjore, e as praktike me kompanitë në Skandinavi të cilat janë përgjegjëse për rrjetin-Tetra (Motorola, Nokia, Ericson etj.) dhe me siguri që Norway Invest, e as Artet, NUK kanë pasur licencë që do t’iu mundësonte atyre krijimin e këtij rrjeti-Tetra në Kosovë. Ka qenë e qartë për të pandehurën dhe partnerët e saj që pa marrëdhënie zyrtare dhe ligjore me Grupit Tetra Indutstri prezantimi i duhur i rrjetit të komunikimit Tetra do të ishte i pamundur.

- që “partneri” i saj Reynolds ka luajtur lojë të dyfishtë si Menaxher i Divizionit AKM/PTK dhe kryetar i Artet (që në të vërtete ligjërisht nuk ka ekzistuar) me qëllim për ti hequr të gjitha dyshimet dhe që të bëjë të mundshme që Isak Krasniqi të bindet për të nënshkruar dokumentin e transferimit (në nën-xhirollogarinë bankare) edhe pse ai – si duket me qëllim – nuk është konfrontuar me faturën origjinale. Sapojanë transferuar paratë në nën-xhirollogarinë ‘PTK-Artet’ të krijuar

Aktgjykimi
Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 435/2008
Leme Xhema et alia




nga e pandehura Leme Xhema, kjo e fundit i ka transferuar ato menjëherë në xhirollogarinë bankare të Norway Invest. Është e qartë që Z. Reynolds ka luajtur rol kyç në këtë transfer joligjor të parave dhe ka mundur ta luaj këtë rol vetëm nëse e pandehura L. Xhema është pajtuar dhe kanë vepruar në përputhshmëri. E pandehura në pozitën e saj si menaxhere e gjenerale e njërës prej ndërmarrjeve publike më të rëndësishme në Kosovë, ka qenë në të vërtete person përgjegjës, i ka ditur saktësisht rregullat e qeverisjes së veprimtarive afariste të kompanisë së saj dhe rregullat e saj të përgjegjësisë. Kjo ka qenë arsyeja pse ajo është pranuar. Pra është së paku naive të besohet që ajo ka qenë e shtyrë dhe nën presion nga Reynolds për ta bërë këtë transfer joligjor të kësaj shume – siç ka deklaruar ajo – dhe siç ka hyrë në këtë bashkëpunim afarist afatgjatë (rrjeti i komunikimit-Tetra) me partnerët si Lars Jensen, Ove Johansen dhe kompanitë komerciale si Norway Invest R&O AS, Norway Invest International, Kompani Norway Invest, Norway Invest Kosovë Ltd, madje edhe pa kontrolluar kredibilitetin dhe kapacitetin e tyre financiar dhe ligjor. E pandehura e ka ditur që së paku Menaxheri i Projektit, Peter B. ka qenë i përfshirë si i dyshuar/akuzuar në një hetim penal.

b. sapa janë pranuar paratë në xhirollogarinë e Norway Invest, gati menjëherë janë shpërndarë nga M. Neziri nëpër xhirollogari të ndryshme bankare madje edhe private pa ndonjë arsyetim ligjor (p.sh. 250.000 Euro Ove Johansenit, 15000 Euro në xhirollogarinë e tij private) dhe vetë M. Neziri ka tërheq 229.000 Euro para të gatshme. Në cilindo rast, gjykata e shkallës së parë ka bërë analizë të saktë të xhirollogarisë së Kompanisë Kosovare Norway Invest, e cila ka pranuar shumën e lartpërmendur të parave, dhe ka vërtetuar që xhirollogaria është kredituar nga Norway Invest R&O AS dhe që ajo xhirollogari është zvogëluar sistematikisht me tërheqjen e parave (pa arsyetim apo dokumentacion) dhe jo me transfere normale financiare komerciale deri më 28 shkurt 2003. Më 1 mars është realizuar transferi prej 300.000 Euro nga PTK-ja. Në atë moment xhirollogaria bankare e Kompanisë Kosovare Norway Invest ka pasur kredit prej - 0,26 Euro.

c. më 14 maj e pandehura Leme Xhema i ka shkruar Sorensenit që vazhdimësia e projektit varet nga “aprovimi dhe konfirmimi me shkrim nga menaxhmenti i AKM-së” që tregon edhe një herë që paraprakisht NUK ka pasur aprovim apo pëlqim nga Menaxhmenti i AKM-së. Në ndërkohë shuma e transferuar (300.000 Euro) i është dërguar përfituesve të ndryshëm (b)

d. prandaj, duke pasur parasysh atë që u tha më lartë, e pandehura e ka ditur saktësisht që duke e transferuar këtë shumë të parave ajo i ka siguruar Norway Investit dhe përfaqësuesve të tij përfitim material joligjor, dhe përmes kësaj pagese të paautorizuar ajo ka ekzekutuar një obligim joligjor duke e zbatuar kontratën e dëmshme të lidhur në mes PTK-së dhe Norway Invest.

Aktgjykimi
Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 435/2008
Leme Xhema et alia



4. Gjykata Supreme gjen që faktet siç janë përcaktuar nga Gjykata e Shkallës së Parë dhe konfirmuar në ankesë, duhet të kualifikohen dhe identifikohen vetëm për Pikën 2, sepse krimi i paraparë në Pikën 2 i konsumon dhe përfshinë faktet e “Shpërdorimit të pozitës zyrtare apo autorizimit” të paraparë në Pikën 1.

Në të vërtetë në këtë rast “lidhja e kontratës së dëmshme” (Pika 2) ka qenë e vetmja e mundshme, dhe pre-supozon shpërdorimin e pozitës apo autorizimit” (Pika 1). Elementet përbërëse të krimit “lidhja e kontratës së dëmshme” është njohuria që kontrata dëmton subjektin ligjor dhe që lidhja e saj është në kundërshtim me autorizimin apo kapacitetin në këtë veprimtari afariste. Gjykata Supreme i përmbahet përkufizimeve ligjore dhe arsytimit ligjor lidhur me krimin “lidhja e kontratës së dëmshme” të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe i referohet asaj si përgjigje në argumentet e përsëritura në ankesë nga e pandehura. Me fjalë tjera pranimi i faturës dhe urdhërimi i pagesës përfundon “kontratën”. Gjykata Supreme nuk ka nevojë për ndonjë ekspert (ekonomik, financiar) siç është sugjeruar nga e pandehura, për ta vërtetuar këtë mendim ligjor e as ekspert për të vërtetuar që një autorizim për të nënshkruar transferimin e kësaj shume të parave (duke e tejkaluar tej mase më shumë se 10 herë) transferin e autorizuar dhe lidhja e kësaj kontrate, mungon dhe nuk ekziston. Ekzistimi i MM-së dhe/apo nënshkrimi dhe /apo aprovimi i bashkëkryerësit (edhe nëse është punëtor i AKM-së) nuk e ndryshojnë ilegalitetin e veprës dhe mungesën e autorizimit për nënshkrim. I ashtuquajtur “presioni apo urdhri nga lart” për të pandehurën që të veprojë në mënyrë joligjore nuk ekziston dhe me siguri që kriteri nga nenet 10 (1)1, 2, 3 të KPK-së nuk është përmbushur.


5. Konsumimi kriminal i lartpërmendur, i vërtetuar nga praktika e Gjykatës, është në dobi të të pandehurës dhe Gjykata Supreme e merr parasysh këtë konsumim në përcaktimin e dënimit më të ulët (në krahasim me dënimin e shkallës së parë) siç është përcaktuar në diapozitiv. Në përcaktimin e dënimit Gjykata Supreme i përmbahet Gjykatës së Shkallës së Parë dhe nënvizon në veçanti:

- shumën enorme të parave dhe dëmin e shkaktuar ndërmarrjes publike,
- pozita e lartë e keqpërdorur nga e pandehura,
- konsumimi dhe koha e kaluar prej fakteve (më shumë se 6 vite) e cila numërohet në dobi të pandehurës.

6. Në përfundim, Gjykata Supreme aplikon nenin 426 (1) të KPPK-së, i përmbahet përcaktimit të fakteve nga Aktgjykimi i Shkallës së Parë, i referohet arsytimit faktik dhe ligjor të Gjykatës së Shkallës së Parë, mirëpo ndryshon Aktgjykimin e Shkallës së Parë në veçanti

- konsumimi ligjor i Pikës 1 në Pikën 2 kështu që e pandehura Leme Xhema dënohet vetëm për Pikën 2,
- i pandehuri Mustafa Neziri lirohet nga të gjitha akuzat për shkak të Parashkrimit dhe nuk obligohet për shpenzimet e procedurës penale,
- e pandehura Leme Xhema dënohet siç është përcaktuar në dispozitiv dhe mbahet përgjegjëse civile për pagesën e dëmeve palës së dëmtuar PTK-së siç është vërtetuar në Aktgjykimin e Shkallës së Parë,

Aktgjykimi
Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 435/2008
Leme Xhema et alia



- pala e dëmtuar PTK udhëzohet që të adresoj padinë e saj eventuale kundër M. Nezirit pranë gjykatës kompetente civile,
- e pandehura Leme Xhema është përgjegjëse për 2/3 e shpenzimeve të procedurës penale, 1/3 për Shtetin për shkak të aplikimit të parashkrimit në dobi të M. Nezirit.

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 435/2008
22 qershor 2009
Prishtinë

Anëtarët e kolegjit:

Miftar Jasiqi
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Kryetar i Kolegjit:

Guy Van Craen
Gjyqtar i EULEX-it



Agim Krasniqi
Gjyqtar i Gjykatës Supreme

Procesmbajtes:

Mircea Cristian Nicoara
Zyrtar Ligjor i EULEX-it